

VENDIM
Nr. 635, datë 10.10.2024

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E MIRATUAR PËR VITIN 2024 PËR
DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERTARE, PËR PËRBALLIMIN E
SHPENZIMEVE TË ORGANIZIMIT TË KONFERENCËS SHKENCORE
NDËRKOMBËTARE “NANOBAKLAN 2024”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në buxhetin e miratuar për vitin 2024, i shtohet fondi prej 12 235 653 (dymbëdhjetë milionë e dyqind e tridhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre) lekësh, për përballimin e shpenzimeve të organizimit të Konferencës Shkencore Ndërkombëtare “*Nanobalkan 2024*”, që do të organizohet në Tiranë, më datë 28 tetor 2024 deri më 1 nëntor 2024.

2. Efekti financiar, prej 12 235 653 (dymbëdhjetë milionë e dyqind e tridhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre) lekësh, përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2024.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku